Kronikë

# Faza e 6-të e operacionit 'Restart' në Korçë, prangosen 4 persona, sekuestrohen 72 kg kanabis! Shkon në 16 numri i të arrestuarve dhe në 445 kg droga e kapur (VIDEO)

*72 kilogramë kanabis janë sekuestruar nga policia e Korçës, ndërsa janë prangosur 4 persona në kuadër të operacionit të koduar 'Restart'. Në kuadër të operacionit antidrogë "Restart 6", u arrestuan në flagrancë shtetasit Klaudio Sino; Bardhi Sino (vëllezër); Blerim Karameta dhe Igli Cangëtari*

HOROSKOPI

Redaksia
8 Prill, 08:47 | Përditesimi i fundit: 8 Prill, 09:06

**KORÇË-** 4 persona janë arrestuar në kuadër të vijimit të operacionit anti-drogë 'Restart' në Korçë, ndërsa janë sekuestruar 72 kilogramë kanabis. Në pranga kanë rënë, vëllezërit Klaudio Sino, 35-vjeç, dhe Bardhi Sino, 38 vjeç, Blerim Karameta, 26 vjeç, banues në Miras Devoll, dhe Igli Cangëtari, 30 vjeç, banues në Çetë, Devoll.

Policia në bazë të informacioneve, se 4 të arrestuarit do të transportonin një sasi droge, ndaluan dhe kontrolluan mjetin tip "Mercedes-Benz", në afërsi të hyrjes së fshatit Miras, Devoll, me drejtues shtetasin Klaudio Sinën. Gjatë kontrollit të ushtruar në automjet, u gjetën e sekuestruan në cilësinë e provës materiale 65 pako, me peshë totale 69 kg lëndë e dyshuar narkotike kanabis.


LEXO EDHE:
**Shkëmbinjtë 'kërcënojnë' 100 familje në Podgorie të Maliqit, banorët: Jemi në rrezik! Bashkia: Pritet ndërhyrja e forcave xheniere për të bërë copëtimin**

Gjithashtu gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e 35-vjeçarit, iu gjetën e sekuestruan edhe 3 kg të tjera lëndë e dyshuar narkotike kanabis dhe një sasi municioni luftarak. Nga veprimet e mëtejshme hetimore, rezultoi se bashkëpunëtorë në këtë aktivitet kriminal, janë edhe shtetasit Bardhi Sino, Blerim Karameta, dhe Igli Cangëtari.

Kjo është faza e gjashtë e operacionit policor të koduar "Restart", startuar pesë muaj më parë. Sakaq ka shkuar në 16 numri i të ndaluarve si dhe është sekuestruar 445, 5 kilogramë lëndë narkotike kanabis, në kuadër të këtij operacioni për goditjen e një grupi kriminal në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike në drejtim të shtetit grek, shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Korce | operacion antidroge | klaudio sino | bardhi sino | blerim karameta | igli cangetari | devoll

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Sondazhi i ditës:
Jeni pro apo kundër legalizimit të kanabisit mjekësor?
Pro | Kundër | Nuk e di

## Lajme të tjera


Kronikë



**Shkelën ligjin 'me 2 këmbë', pezullohen 9 zyrtarë të pyjores në Korçë, Tiranë dhe Kolonjë, lejuan prerjen e paligjshme të pyjeve**

7 Prill, 14:33

Kronikë



**Aksident në aksin Korçë-Bilisht, një 17 vjeçare në gjendje të rëndë niset drejt Tiranës! Arrestohet shoferi, ishte në gjendje të dehur**

6 Prill, 10:16

Politikë



**Salianji nga Korça: Bashkimi i demokratëve vetëm përmes votës dhe jo proceseve të njëanshme! PD s'ka ende propozim për Presidentin, kujt i është përmendur emri ta përgënjeshtrojë**

3 Prill, 18:26

Kultura



**'Ëndrrat që mbartim', çelet në Korçë ekspozita që portretizon dramën e refugjatëve sirianë në Shqipëri**


Gladiola Hoxha

7 Prill, 13:55


Kronikë



**Baste me telefona nëpër lokale, arrestohen 2 persona në Korçë**

4 Prill, 16:06

Kronikë



**Mbante ilegalisht në punë 15-vjeçarin dhe e linte të vendoste baste, shpallet në kërkim pronari i lokalit, nis hetimi ndaj të miturit në Pogradec! Arrestohet edhe një 67-vjeçar në Korçë për lojëra fati**

3 Prill, 10:43

Kultura




**'Në premierë dështova dhe nisa të qaja', aktorja Zamira Kita rrëfen gjithçka "N'kohë", nga malli për estradën e vjetër te raporti me skenën sot**


Ermal Qori

2 Prill, 22:25

Sociale




**Iu dogj stalla me 40 keca e viça në Maliq, flet për Report Tv blegtori: Katastrofë, kërkoj dëmshpërblim nga shteti**


Gladiola Hoxha

2 Prill, 12:04


Kronikë



**Zbulohen 10 sera për kultivim kanabisi në Thumanë, sekuestrohen 925 fidanë! 2 të arrestuar, 1 në kërkim**

7 Prill, 08:49

Kronikë



**Treguan pasaporta false, kapen në pikën e Kapshticës dy afrikanët! U ndihmuan nga një francez**

4 Prill, 13:07

Sociale



**Reshje dhe temperatura me minus, trashësia dëborës deri në 20 cm në Korçë**

3 Prill, 10:01

Kronikë



**Dyshohet se ngacmoi seksualisht vajzën e tij 8 vjeçe, ndalohet 61-vjeçari në Korçë**

1 Prill, 13:29



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje